



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 02.08.2019, ora 12.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. *Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.*
2. *Vendimmarrja lidhur me lejimin ose ndalimin e kandidimit të kandidatëve Eris Hysi dhe Klodian Rado për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Eriol Roshi | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

Vendimmarrja lidhur me lejimin ose ndalimin e kandidimit të kandidatëve Eris Hysi dhe Klodian Rado për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto.

Eriol Roshi parashtron relatimin për kandidaten Zhaklina Peto për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Margarita Buhali shprehet se relacioni ishte i detajuar në të dhëna. Sipas faqes 39 të Raportit të ILDKP-së kandidatja ka deklaruar pasuri e të ardhura totale neto 36.021.000 lekë. Pak a shumë vlera që ka nxjerrë eksperti për të ardhurat e saj, është rreth 35 milion, dmth. është aty afër. Pyetja është nëse është parë a ka paguar tatime tek deklaratat që ajo ka bërë pranë tatimeve për interesave vjetore dhe nëse janë mbajtur tatime, a janë bërë zbritje nga eksperti këto në vlerat neto që ajo ka pasur disponibël? Flas për DIVa-n sepse në tatime duhen deklaruar të ardhurat.

Eriol Roshi shpjegon se eksperti ka argumentuar që janë nga burime të ligjshme. Verifikimet janë bërë për të gjitha transaksionet nga banka për znj. Zhaklina dhe për personin e lidhur dhe

eksperti ka dhënë konkluzion, mbase nuk e ka dhënë shprehimisht, por derisa e ka thënë që janë të ligjshme, e ka prezumuar. Eksperti nuk përgjigjet në mënyrë qartë të detajuar për pagesën e tatimeve por thotë transaksionet janë bërë në bankë në mënyrë të ligjshme.

Erinda Ballanca shprehet se pikërisht në lidhje me këtë fakt, përtej konkluzionit të ekspertit. Lind pyetja a ka në dosje një kopje të deklaratave vjetore të të ardhurave, duke qenë se rezultojnë se i kalon vlerën prej 2 milion lekesh, pra për vitet 2013-2014-2015? Sepse mund të ketë paguar, por vlen për tu verifikuar nëse e ka kryer këtë detyrim? A është marrë ky dokument për të evidentuar, pavarësisht pagesës në bankë, sepse praktikisht edhe unë kam marrë në bankë nga një klient një shumë të caktuar, por tatimin nuk e kishte mbajtur dhe u detyrova të bëj deklaratën dhe kam paguar tatimin për atë vit, për atë shumë që më ka ardhur nga banka.

Eriol Roshi sqaron se në shpjegimet e saj të datës 5 qershor, kandidatja tregon të ardhurat e saj për periudhën 2010-2014 dhe dokumentet bankare ku janë pasqyruar. Pastaj tregon edhe totalin e të ardhurave nga qiradhëniet dhe për kredinë bankare. Këto janë edhe me dokumente që ndodhen në dosje. Por duhet të mbahet parasysh edhe momenti i ndryshimit të ligjit lidhur me këto lloje deklarimesh sepse bëhet fjalë për të ardhura të viteve 2007-2009, që janë të ardhura vetëm nga puna, nga honoraret dhe nga pagat.

Erinda Ballanca shprehet se tek lista honorarëve ishin një sërë honorarësh që ishin të ardhura nga veprimtari të tjera profesionale, sigurisht shumë mirë dhe nuk kam ndonjë problem nëse duam që njerëzit të jenë sa më mirë ekonomikisht. Pyetja që unë kam, a e ka bërë deklarimin e të ardhurave personale nëse e kalon vlerën e parashikuar nga ligji?, kjo është për çështjen e zbatimit apo verifikimit të të ardhurave ?

Eriol Roshi sqaron se në dokumentacionin tonë por edhe të ILDKPKI janë pasqyruar të dhënat, përmenden edhe DIVA-t në një farë mënyre. Më duhet të shfletoj për ti parë. Gjenden të dhëna në dosjen e madhe të verifikimit të pasurisë së kandidatës

Vitore Tusha shpjegon se një konkluzion në të cilin ka arritur ILDKPI, duke e krahasuar me përgjigjen që ka dhënë kandidatja, *rezultojnë se kandidatja ka deklaruar kontratë qeraje datë 02.12.2009, me palën qiradhënëse kandidaten dhe qiramarrës një shoqërinë, jep të dhënat që apartamenti ndodhet në, me sipërfaqe 35.5 m2.* Përgjigja që ka dhënë në lidhje me këtë kandidatja është se pasuria e dhënë me qira, është përfituar me kontratënkol/rep datë 17.03.2000. Kjo është e njëjta pasuri e cila është në deklaratën e pasurisë dhe të interesave private dhe sipas këtij shpjegimi lidhur me pretendimin që ILDKPI –se që nuk ka deklaruar të dhënat e pronësisë, vlerën, kohën etj., sqaroj se kontratat e qirasë kanë shërbyer pikërisht për të treguar marrëdhënien juridike që ka pasur me këtë pasuri dhe janë provë për të mbështetur të ardhurat e pasqyruara në statement. Edhe pastaj jep të dhënat se si janë përcaktuar më pas në kontratë

qiradhënia, vërtetimin e pronësisë etj. Pra sipas përcaktimeve të dhëna në fillim dhe në vazhdim kjo e dhënë me kontratën e shitjes së datës 17.03.2000 përkon me apartamentin e parë që ju shpjeguat dhe që është në dhe jo në Më pas në faqen tjetër, këtu kemi 53.6 m2 që është shtesë ndërtimi pa leje që është diskutuar, ndërkohe këtu flitet për një apartament tjetër 35.5 në Rr..... A keni ndonjë të dhënë tjetër se unë këtë përgjigje nuk e kam kuptuar, dmth. nuk më harmonizohet?

Eriol Roshi sqaron se nuk kam asnjë të dhënë tjetër përveç asaj në shpjegimet e kandidatës.

Avokati i Popullit znj. Erinda Ballanca -apartamenti është në kënd mes dy rrugëve që janë Prandaj ndoshta specifikimet që i bëjnë një herë sipas kësaj rruge e një herë sipas kësaj rrugës tjetër. Pse po e shpjegoj sepse diskutimi është konfondimi midis të dhënave të kontratës së qerasese në kontratën e qerasese secili prej nesh mund të ketë një përshkrim, mjafton të jetë shkruhet edhe në mënyre të përafërt.

Eriol Roshi sqaron se numri i kontratës që referon kandidatja dhe i asaj që është deklaruar në Raportin e ILDKPKI është po ai,kol/rep datë 17.03.2000.

Erinda Ballanca shprehet se në momentin që është dhënë me qera shtesa lart nuk ka qenë regjistruar sepse ka qenë shtesë e bërë përpara, këtë e shpjegon kandidatja se ka blerë një apartament që ka pasur një sipërfaqe të ligjshme plus një sipërfaqe që ka qenë ndërtuar me përpara por nuk ka qenë e regjistruar.

Eriol Roshi sqaron se është i njëjti apartament sepse referencat që jepen janë kol/rep datë 17.03.2000, pra kjo është në Raport. Por si numër pasurie referenca është për rrugëni në dokumentet e ZVRPP.

Erinda Ballanca shtron pyetjen se çfarë të dhënash, çfarë shpjegimesh ka dhënë kandidatja në lidhje me pretendimin për fitimin të pasurisë nëpërmjet një okazioni, a ka ndonjë dokument përveç asaj që ka thënë. Nëse pretendohet se për njërin nga rastet, që me një vlerë aq të ulët apartamentin e ka blerë gjatë kohës së martesës së parë, për këtë apartament pretendon që ia kemi blerë një personi i cili ishte përfaqësues me prokurë një njeriu i cili donte të ikte nga Shqipëria pasi shpallur si i kërkuar në listën e terroristëve. Por ai është shpallur pas 4 vjetësh në atë listë sepse apartamentin e ka blerë në vitin 2000. Pyes a ka ndonjë dokument tjetër ta vërtetojë sepse ka një diferencë kohore 4 vjet?

Eriol Roshi sqaron se mund ta vendosja në dukje në relativitet por është e pasqyruar ky veprim dhe nga cili është kryer. Po kështu kandidatja e pranon që shtesat pa leje janë bërë përpara blerjes së apartamentit nga ana ime. Nuk është ndërtuar nga unë, është legalizuar nga njëri prej bashkëpronarëve që kanë blerë apartamentin. Ka dokumente, prokurë etj. që është blerë atëherë nga zotëria që më vonë doli me probleme dhe në listë. Por kandidatja nuk thotë e kam blerë me okazion, e thotë për automjetin këtë gjë. Në shpjegime pranon se në Deklaratën e pasurisë kam deklaruar

apartament me sipërfaqe 130.3 m², në adresën.....Bashklidhur deklaratës kam paraqitur edhe lejen e legalizimit për 53.6 m³ ndërtim dhe afërsisht 64 m² verandë. Faktin e legalizimit nuk e kam deklaruar shprehimisht por kam dorëzuar dokumentin përkatës dhe kam bërë bashkimin e pasurive.

Erinda Ballanca shtron pyetjen se a është vlera prej 3 milion e 900 mijë lekë, si vlerë e apartamentit të banimit 130 m² plus 130m² tarracë në Rr....., në vitin 2000, të cilën ILDKPKI e gjykon të jetë e ulët?

Eriol Roshi sqaron se ky është konstatim i ILDKPKI. Por kandidatja nuk ka thënë diçka të tillë vetëm se pasurinë e kam blerë efektivisht dhe këtë pjesë nuk e kam ndërtuar unë, krahas pjesës që ishte me leje.

Fatri Islamaj shtron pyetjen nëse eksperti kontabël është marrë me këtë punë? Pa llogaritur shtesën sa ishte e gjithsej sipërfaqja? Për të bërë këtë përlllogaritje eksperti ka marrë parasysh faktin që ishte dhe një sipërfaqe shtesë?

Eriol Roshi sqaron se eksperti ka përshkruar çmimet e shitblerjes spas vendimeve të qeverisë së kohës, në vitet 1999-2000, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të EKB-së dhe se për vitin 1999 nuk ka të dhëna për vlerën e tregut të shitjes së banesave duke dhënë tabelat për kostot mesatare të qytetit të Tiranës. Mbi bazën e këtyre llogaritjeve eksperti ka nxjerrë vlerën sipas këtyre referencave të vitit 2000. Nuk më rezulton që ta ketë llogaritur edhe lidhur me shtesën por jep çmimin për metër katror sipërfaqe ndërtimi. Për të gjithë sipërfaqen apo pa shtesën në këtu jemi dhe i bëjmë llogaritë përkatëse se është veprim i thjeshtë sepse shtesa nuk ka qenë pjesë e kontratës.

Erinda Ballanca shtron një pyetje në lidhje me diferencën për çmimin e apartamentit e dytë. Pretendohet se është bërë rivlerësimi i apartamentit dhe prandaj çmimi është në rregull. Unë e kuptoj që mundet të duket një afat i shkurtër fakti se kur e ka fituar ajo pronësinë por momenti i kontraktimit mund të ketë qenë një moment tjetër për ta justifikuar ndryshimin e çmimit sepse në atë zonë, tek, një numër i madh apartamentesh nuk janë regjistruar menjëherë. Ka patur probleme me regjistrimin e pronave nga ana e ndërtuesit. Dua që të pyes nëse momenti i kontraktimit i deklaruar nga znj. Peto me momentin e shitjes ka pasur një periudhë të gjatë kohore apo jo? Që të justifikohet në gjykimin tim ndryshimi i çmimit sepse nuk e shoh të logjikshëm faktin që e kam bërë unë rivlerësimin sepse po të jetë çështja e rivlerësimit njeriu rivlerësimin e bën me kë të dojë, merr një ekspert që të thotë është caq vlera. Nëse bëhet fjalë për diferencën e çmimit, midis çmimit që ka paguar dhe diferencës së shitjes e që pretendohet nga ILDKPI që koha është e shkurtër. Prandaj po pyes a mos koha ka qenë më e gjatë pavarësisht momentit të fitimit të pronësisë por e ka kontraktuar më parë për efekt të çmimit?

Eriol Roshi sqaron se për një përgjigje duhet ti referohemi kontratave dhe të dhëna të tilla vihen gjithmonë tek porosia e parë që është apartamenti i parë. Referimi i parë është kontrata e datës

30 tetor 2009, ajo e sipërmarrjes. Kontrata e dytë ku bëhet kalimi i të drejtave të pronësisë me të njëjtën firmë ndërtuese është e datës 25 prill 2015. Kjo është shitur në datën 23 shkurt 2017. Apartamentin e këmbyer nga firma ndërtuese kandidatja e ka shitur më pas në 6 qershor 2018 një të treti. Periudha është rreth 9 vjet dhe çdo veprim ka ndodhur për rreth çdo 1,5 vjet. Aty ka një problem tjetër ligjor se ka paguar paratë para se të marrë çmimin e shitjes.

Erinda Ballanca shtron një pyetje në lidhje me analizën, pra nëse ka analizuar apo jo eksperti pikërisht edhe këto diferencat në kohë meqë nuk keni bërë pyetje konkrete dhe kjo ka të bëjë me faktin se ka pasur vërtetë mundësi të tjera financiare për ta paguar atë çmim që e ka paguar para kohe? Dhe e fundit, për apartamentin e prenotuar në vitin 2018. Për apartamentin e parë jam e qartë se ka deklaruar që ka mbuluar me shumat dhuratë dhe hua të tezes dhe të nënës që kanë marrë nga ana e tyre kështu e parë nga kontrata e shkëmbimit të truallit për ndërtim, ku huanë tezes ia kemi kthyer kur është paguar çmimi i dytë. Këtë gjë mund ta kuptoj pavarësisht se duhet të ishte bërë një verifikim i mëtejshëm nëse tezja vërtet vazhdonte ti kishte ato para, i tërhoqi në banke apo i mbante në bankë nuk dua ti hyj, unë them që ka një justifikim por për pjesën e dytë nëse ka apo jo ?

Eriol Roshi sqaron se eksperti në tërësi është shprehur se kandidatja ka burime të ligjshme dhe e justifikon blerjen e kryer. Kandidatja ka argumentuar se ka qenë edhe vlera e apartamentit të shitur më parë, por për këtë blerje kam pasur edhe këto të ardhura të tjera nga puna personale dhe nga qiraja që eksperti i ka përlllogaritur të gjitha dhe i quan të ligjshme.

Mbledhjes i bashkohet anëtarja e Këshillit Arta Marku.

Fatri Islamaj shtron një pyetje e kërkon sqarim më shumë vetëm për procedurën. Nuk jam i qartë nga akti i ekspertimit. Duket që është bërë një deklaram i gjatë i të ardhurave nga Fakulteti i Drejtësisë për honorarët, edhe eksperti i ka trajtuar, janë përshkruar të ardhurat e orëve shtesë dhe të pagesave. Më bën përshtypjen në faqen 9 orë mbingarkese dhe në pikën 38 për vitin 2018 janë bërë shume pagesa, por një prej tyre është 1.600,245. Janë të provuar nga kandidatja me vërtetime nga Fakulteti apo nga kanë ardhur këto të dhëna?

Eriol Roshi sqaron se këto të dhëna janë nxjerrë nga eksperti nga dokumentet e llogarive bankare të kandidatës të deklaruara në ILDKPKI ku tregohen lëvizjet në llogari. Ai ka listuar, nuk i ka dhënë aq në mënyrë të detajuar. Nëse ka gabim material në tabelat e përgatitura këtë nuk mund ta them. Duhet parë në llogaritë bankare.

Vitore Tusha shtron pyetjen se kur është këmbyer apartamenti 110m² me atë 156 m². Momenti është logjik që shkëmbimi rezultonte po them i saktë sepse 110m² ishte apartament i ndërtuar tërësisht, ndërsa 156 m² apartamenti ishte vetëm në gjendje karabinaje. Ky apartament pastaj është shitur dhe është ndërtuar nga kush? Apo nuk ka hetim për këtë drejtim. Domethënë,

kështu është shitur karabinaja që ju rrit çmimi, në këtë gjendje që ishte? Nëse ka bërë punime për ta shitur kush i ka bërë atë shpenzime?

Eriol Roshi sqaron se është kontratë shitje kjo e fundit. Besoj ka qenë i përfunduar sepse ka të dhëna nga ILDKP-ja që ka qenë e regjistruar dhe që është rishitur në vlerën 170 mijë euro. Kur është bërë rivlerësimi. Nuk del ndonjë e dhënë më shumë por logjika është që ka vazhduar punimet firma ndërtuese, e ka ndërtuar deri në fund dhe pastaj e ka dorëzuar objektin. Pavarësisht nga sa shpjegon kandidatja logjika është kjo, nga pikëpamja juridike. Ka një kontratë kalimi të të drejtave të pronësisë, aq më tepër që pranohet që ka qenë karabina dhe kur është bërë shitja, logjika ta thotë ka përfunduar objekti dhe është rregjistruar në ZRPP dhe më pas është bërë rivlerësimi.

Vitore Tusha shtron pyetjen ato 28 mijë euro që ishin kthyer nga firma kandidates meqenëse shoqëria nuk i pranonte gjendjen KESH dhe për të riparuar apo për të strukturuar këtë marrëdhënie midis tyre. A ka ndonjë dokument tjetër që këtë shumë e ka paguar apo aty është stopuar?

Eriol Roshi sqaron se janë shlyer detyrimet dhe kandidatja thotë gjithmonë që janë plotësuar nga të ardhurat personale. Detyrimet janë shlyer po me bankë. Po të ishte që ka akoma detyrime duhet ta kishte konstatuar edhe ILDKPI, por nuk është se e ka nxjerrë sikur ka detyrime ndaj personave të tjerë.

Erinda Ballanca shprehet se i pashë pyetjet që i keni bërë ekspertit dhe në fakt i keni bërë vetëm në lidhje me çështjet e pasurisë. Por duke qenë se pretendimi është marrë për mundësinë e të ardhurave që duhet të kishte kandidatja dhe unë shikoj që referencat që ka bërë eksperti i ka bërë vetëm me mesataren e shpenzimeve sipas INSTAT-it. A i është bërë ndonjë pyetje kandidates në lidhje me nivelin e shpenzimeve të saj? Apo duke qenë se të ardhurat nga bankat janë dhe eksperti i ka parë bankën ndoshta duhet parë çfarë nivel shpenzimesh real ka pasur kandidatja?

Eriol Roshi sqaron se jo nuk është bërë pyetje e tillë, pastaj nevoja për këtë mund të diskutohet me Këshillin.

Ardian Dvorani fton Avokaten e Popullit të shprehë mendimin e saj për procedurën e ndjekur në verifikimin e kandidates.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se qëndrimi që kemi, të cilin do ta sjellim edhe me shkrim, është se, së pari, përsëri duhet thënë që ka ardhur një pjesë e dokumenteve. Këtë e kemi të evidentuar në mënyrë të hollësishme e do ta paraqesim në materialin me shkrim se cilat janë dokumentet që ne nuk i kemi në lidhje me dosjen, duke qenë kjo një problem i vazhdueshëm. Pavarësisht kësaj, nuk duam që të mos japim mendim apo qëndrim në lidhje me çështjen. Mendojmë që nëse Këshilli, për të gjitha rastet dhe procedurat, do të kishte pasur një qëndrim të ndryshëm nga ai i ILDKPI do të duhej që në çdo rast të kishte thirrur një ekspert. Kjo ka qenë një nga gjërat që ne e

kemi paraqitur edhe në qëndrimin tonë me shkrim në rastet e mëparshme. Shumë mirë që në rastin konkret ka një ekspert. Pyetja që mund të lindë është nëse ky është trajtim i barabartë apo i pabarabartë i kandidatëve në dhënien e mundësisë së marrjes së një eksperti për përmirësimin e situatës së vetë financiare apo jo. Në këto kushte jemi të mendimit që shumë mirë që u mor ekspert, por ama eksperti dhe pyetjet që duhet ti caktohen nuk janë pyetje që duhet të bëhen vetëm nga relatori. Janë pyetje që duhet të bëhen edhe nga Këshilli ose duhet të ishin miratuar pyetjet apo eksperti që të relatonte përpara Këshillit. Nuk është një vendimmarrje, në gjykimin tim, që do jetë vetëm e relatorit, por është e Këshillit. Duke qenë se është vendimmarrje e Këshillit për problematikat që mund të ndodhin në lidhje me të dhënat që eksperti ka paraqitur llojin, natyrën edhe të pyetjeve që i janë bërë, ndoshta do të ishte mirë që eksperti të mbronte aktin në Këshill pasi edhe ligji thotë Këshilli merr ekspert. Duke qenë se Këshilli merr ekspertët, ata duhet që të relatojnë përpara Këshillit.

Për sa i përket detajeve, mendoj që nëse ka një arsyetim ose një argumentim më të saktë për sa i përket një pjese të çështjeve edhe mundet të kalojë. Por ka nevojë për një shpjegim të mëtejshëm për disa gjëra të cilat, edhe pas kryerjes së ekspertimit, vazhdojnë të mbeten problematike, pavarësisht çështjes së faktit që nëse kërkon shpjegime shtesë apo arsye shtesë apo dokumenta shtesë mundet të rregullohen apo mundet të të përmirësohen nga kandidatja. Arsyeja pse e them këtë është gjithmonë për të shikuar nëse Këshilli do të kishte një vendim pozitiv për lejim, ky vendim të ishte i argumentuar plotësisht. Do të jetë një nga të paktat raste, përveç rastit të znj. Elsa Toska që do të kalojë me një vendim të ndryshëm nga ajo e ILDKPI-së dhe do të doja që, për efekt transparence dhe të besimit të publikut, të kishte një argumentim. Sigurisht pa e diskutuar që Këshilli do ta marrë vendimin e tij, do ta arsyetojë qartësisht vendimmarrjen. Por për këtë, mendoj që do të duhet që eksperti të ishte i pranishëm dhe pyetjet ti bëheshin ekspertit nga Këshilli. Për sa i përket procedurës që na u paraqit dhe mënyrës se si është caktuar eksperti dhe pyetjet apo kërkesat mendoj që kishim dy tre paqartësi dhe pasaktësi, por që nëse eksperti pyetet nga ana e Këshillit mendoj se ato janë të tëra të sqarueshme dhe të kalohet ai si moment procedural, në mënyrë që të kryhet hetimi i plotë dhe të arrihet në një konkluzion. Faleminderit.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto.

Arta Marku parashtron relatimin për kandidaten Zhaklina Peto për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtares nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime, ndoshta pa i përsëritur ato të cilat u paraqitën dhe u dhanë shpjegime e sqarime në shqyrtimin e rastit të mëparshëm të kandidimit të së njëjtës kandidate.

Arta Marku shprehet se pyetjet e karakterit teknik mund ti bëhen vetëm ekspertit. Konkluzionet janë prezantuar prej tij dhe se si ka arritur eksperti në ato konkluzione. Nëse mund ti kishim bërë vetë ne nuk do të kishim nevojë për ekspert, po i analizonim vetë.

Erinda Ballanca shtron nevojën për sqarim të mëtejshëm sepse tek vlera e apartamentit të parë që nga ILDKPI-ja argumentohet se 3 milion e 900 mijë është vlerë e ulët, si apartament që është në bllok dhe për në vitin 1999, sipërfaqja e tij është mbi 200 m², 130 m² është me dokument pronësie dhe sipërfaqja tjetër është tarracë në të cilin është ndërtuar. Edhe eksperti a është bazuar në vlerën totale të ndërtimit në atë kohë apo vetëm mbi vetëm mbi atë të vërtetimit të pronësisë së vitit 2000.

Eriol Roshi edhe në cilësinë e relatorit të njëres vakancë të kandidatës, sqaron se duket sikur 130 m² është bashkimi i këtyre dy pjesëve. Aty nga deklarimi i kandidatës parashtrohet se janë 130 m² janë nga bashkimi me atë që është vetëdeklaruar. Ndoshta është ashtu por nuk e kemi kuptuar të tillë. Edhe eksperti për dhënien e mendimit që çmimi i shitblerjes nuk është i ulët i është referuar të dhënave të kontratës dhe mbi të gjitha kostos mesatare të ndërtimit për metër katror, sipas legjislacionit në fuqi të asaj kohe, viteve 1999-2000 në qytetin e Tiranës. Përveç kësaj 130 m² të deklaruar sot janë edhe nga pjesëtimi i pasurisë që ka bërë kandidatja. Ka deklaruar se kanë blerë 130 m² dhe pjesa tjetër ka qenë ekzistuese dhe është vetëdeklaruar. Sot gjenden 130 m² për shkak të pjestimeve. Eksperti ka dhënë çmimin për metër katror dhe është një veprim i thjeshtë që mund ta bëjmë edhe ne pastaj për sipërfaqen 130 m² apo 260 m². A do të llogaritet çmimi me atë mesatar të EKB apo me çmimin sipas vlerës së tregut kjo nuk është çështje për ekspertin kontabël, e vlerësojmë ne.

Ardian Dvorani fton Avokaten e Popullit të shprehë mendimin e saj për procedurën e ndjekur në verifikimin e kandidatës.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se i njëjti rast është dhe fatmirësisht zonja Marku pikërisht ato ngriti ose konfirmoi ato që ishin shqetësimi im sepse tha që këto pyetje duhet ti bëni ekspertit, janë pyetje teknike, nuk janë pyetje për mua. Kështu që ishte e qartë. Qëndrimin e mbajta pas relatimit në rastin e parë dhe në fakt edhe pas shpjegimeve shumë të hollësishme për të cilat do ta falënderojmë relatorin Roshi që pati një impenjim të rëndësishëm sot në mbledhje.

Ardian Dvorani, njofton se këto ishin dy rastet e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto. Problematikat që dolën Këshilli do ti diskutojë për të vlerësuar si do të procedohet. Me kërkesën e znj. Margarita Buhali, në cilësinë e relatores së kandidimit të znj. Eris Hysi në vakancën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, parashtrohen disa të dhëna që rezultojnë nga informacionet e ardhura në proces.

Margarita Buhali parashtron se meqenëse janë shtyrë dy vendimmarrjet e KED lidhur me kandidatët për Inspektor i Lartë i Drejtësisë z.Klodian Rado dhe znj.Eris Hysi, gjatë kësaj kohe ashtu si u vlerësua nga KED, u morën nga Gjykata e Tiranës disa të dhëna shtesë për sa i përket regjistrimit të shoqatës ku pretendonte se kishte dhënë kontributin e tij kandidati Klodian Rado, pra e gjithë dosja. Nga procesverbali del një nga themeluesit z.Klodian Rado, i cili është gjithashtu edhe në aktin e themelimit, edhe në statut. Kemi edhe një përgjigje nga Fakulteti Histori-Filologji, duke qenë se kandidati kishte pretenduar që për periudhën 2004, 2005, 2006 kishte punuar njëkohësisht edhe tek Fakulteti Filologjik. Kanë dërguar shkresën e datës 01.08.2019 sipas së cilës parashtrohet që për këto raster nuk kemi të dhëna, pasi i takonte Fakultetit të Drejtësisë që i sillte pedagogët. Pra duhet të mbetemi në referimet që ka bërë Fakulteti i Drejtësisë.

Erinda Ballanca shtron nevojën për sqarim sepse për efekt të llogaritjes së viteve nuk mund të dublohen periudhat se mund të ketë dhënë një periudhë kohe atje një periudhë kohe këtej. Burimi i vetëm i periudhës për efekt të vjetërsisë do të jetë ai i cili është në vërtetimin e Fakultetit të Drejtësisë, me muajt përkatës. Pyetja që unë kam në lidhje me faktin e përvojës profesionale për efekt të Inspektorit. Së pari ka dy kritere. Përmend termin jurist i spikatur dhe që duhet të jetë me përvojë profesionale 15 vjeçare. Dua të pyes nëse për këtë periudhë, përveç vërtetimit që është nga shoqata ku ka qenë jurist a ka ndonjë produkt konkret sipas dokumenteve të shoqatës meqenëse duhet të kishte një departament juridik i cili do të mbronte do të mbronte pa para pro bono qytetarët. Pra a ka pasur ndonjë aktivitet real për të vërtetuar punën e tij reale si jurist? Përvoja profesionale mundet të jetë edhe pa pagesë. Mjafton që të ketë kryer atë aktivitet edhe pa pagesë, por a e ka kryer realisht?

Margarita Buhali sqaron se me aq sa e kam parë, të paktën pjesën e veprimtarisë pjesën e përvojës, mua nuk më rezulton që të ketë paraqitur ndonjë akt që të lërë gjurmë për atë periudhë të veprimtarisë së vet. Megjithatë ne do ta verifikojmë edhe te pjesa e dokumentave profesionale në rast se ka sjellë ndonjë të dhënë shtesë.

Erinda Ballanca shtron pyetjen nëse kandidati apo zyra avokatore ku pretendon se ka punuar ka qenë i regjistruar si subjekt i licencuar?

Margarita Buhali sqaron se për këtë pjesë ishte vetëm vërtetimi nga Ministria e Drejtësisë që tregon se ishte i regjistruar si asistent tek kjo zyrë avokatore dhe duke vlerësuar këtë vërtetim që ai është regjistruar tek kjo zyrë avokatore nuk e vumë në dyshim që i ndjeri kishte pasur një zyrë avokatore në atë vit. Kandidatit i është kërkuar edhe për këtë periudhë sigurimet, i është kërkuar dhe kontratë. Deri më tani nuk ka sjellë.

Margarita Buhali në lidhje me kandidaten Eris Hysi, parashtron se sapo na erdhi në fakt kthimi i përgjigjes për këtë kandidate nga tatimet. Ishte debati i deklarimit apo jo të të ardhurave nga

fitimi e shpërndarja që ka bërë shoqëria e thjeshtë midis ortakëve. Në fakt për pyetjen e parë nuk e kuptoj dhe aq shumë përgjigjen në raport me atë që i kam kërkuar, për më shumë duhet parë edhe shkresa. Nuk kam kërkuar shpjegime për deklarimin e dividendit por për të ardhurat që vijnë nga shpërndarja e fitimit.

Në vijim lexohet nga relatorja përgjigja e ardhur nga organet tatimore.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se nuk ka lidhje fare me atë ç'ka u diskutua lidhur me kandidatët. Por ngaqë ka ngelur pjesa e fundit e kandidatëve do të lejohen apo do të ndalohen, e gjithë vëmendja është shtuar, është e pritshme të shtohet. Këshilli pavarësisht vendimeve për lejim apo ndalim të secilit prej tyre, ju do i diskutoni në mbledhje, duhet që këto vendimmarrje të jenë sa më të arsyetuara, mos të lenë shteg asnjë lloj keqinterpretimi. Tashmë kemi përplasje dokumentash midis një institucioni dhe institucionit tjetër, mendime, ekspertiza etj.. Vendimet të jenë shumë shprehës në mënyrë që Këshilli të jetë i qartë të paktën në publik.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 14.12

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Redjona MYRTJA

Dorina DULAJ

KRYETARI

Ardian DVORANI